



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 226, Datë 10.08.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SH.P.K. PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1922/5 prot., datë 07.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”

Konstatohet se:

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1922 prot., në datën 22.06.2026, brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 06.07.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.07.2026 dhe 08.07.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.07.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Gjatë shqyrtimit të aplikimit, me shkresën nr. 1923/3 prot., datë 15.07.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, por nga verifikimi rezulton se aplikimi nuk është ende i plotë.
- Konkretisht, mbetet të dokumentohet në mënyrë të plotë disponueshmëria e mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe të depozitohen në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin Prokura e Posaçme dhe Vendimi i Ortakut të Vetëm. Pavarësisht

njoftimit të dërguar nga ERE për plotësimin e këtyre mangësive, nuk rezulton të jetë depozituar dokumentacioni i kërkuar.

- Në këto kushte, duke qenë se dokumentacioni i munguar është i nevojshëm për vlerësimin përfundimtar të kërkesës dhe në përputhje me nenin 14, pika 3, të Rregullores, vlerësohet e arsyeshme zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s, duke i lënë shoqërisë një afat prej 20 (njëzet) ditësh për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria të depozitojë në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi dokumentacionin e munguar të përcaktuar në këtë vendim.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI